



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.09.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik IMPACT ENERGY L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik IMPACT ENERGY L.L.C., e dt.26.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 24.09.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:24.09.2025;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik IMPACT ENERGY L.L.C., me dt.26.09.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.09.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Juve si Operator Ekonomik ju mungon vendimi për menaxherin e projektit dhe udhëheqësin punishtes, si dhe inxhinjerin e mekanikes e keni prezentuar me diplome bachelor e jo siç eshte kërkuar në FDT inxhinjer i diplomuar apo master i inxhinjerise mekanike drejtimi termooenergjetik si dhe ju mungojnë CV-të, prandaj oferta juaj është refuzuar si administrativisht e papërgjegjshme.

Sa i përket pretendimeve tuaja për Operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, Autoriteti kontraktues sqaron se i njëjti plotëson kërkesat e FDT-së, dhe pretendimet tuaja nuk qëndrojnë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;